

VENDIM
Nr.540, datë 25.7.2019

PËR MIRATIMIN E MASAVE TË NEVOJSHME PËR MBAJTJEN E
PËRGJEGJËSIVE TË ZGJERUARA TË PRODHUESIT NGA ÇDO PERSON FIZIK
A JURIDIK, QË PRODHON, PËRPUNON, TRAJTON DHE SHET LËKURË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është miratimi i masave të nevojshme, që çdo person fizik/juridik, i cili prodhon, përpunon, trajton lëkurën dhe e shet (prodhuesi), mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan”, të përcaktuar në ligjin nr. 10431/2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

2. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i masave që duhet të respektojnë operatorët e instalimeve për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, konkretisht për:

a) parandalimin e mbetjeve të gjeneruara nga instalimet e prodhimit, trajtimit dhe përpunimit të lëkurës;

b) procedurat, teknikat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve nga instalimet e prodhimit, trajtimit dhe përpunimit të lëkurës;

c) trajtimin e ujërave të ndotura industriale përpara shkarkimeve të tyre në grova septike dhe trupat e tjerë ujorë pritës;

ç) trajtimin e diferencuar të kimikateve të rrezikshme dhe shmangien e shkarkimit të tyre në mjedis;

d) aplikimin e teknologjive më të mira në dispozicion (TMD), që bëjnë të mundur ripërdorimin e ujërave të ndotura industriale, me qëllim pakësimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura në mjedis;

dh) sigurimin e kushteve dhe pajisjeve për të mbrojtur mjedisin, shëndetin e punonjësve dhe të njerëzve, që bien në kontakt me mbetjet e gjeneruara nga këto instalime;

e) përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit për minimizimin e mbetjeve që gjenerohen nga instalimet e prodhimit, trajtimit dhe përpunimit të lëkurës, ripërdorimin, rikuperimin, riciklimin dhe trajtimin specifik të diferencuar të mbetjeve organike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve, mbi baza profesionale;

ë) përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit për menaxhimin e mbetjeve të lëkurës, që teprojnë pas trajtimit dhe përpunimit teknologjik të tyre, mbi baza profesionale.

3. Ky vendim zbatohet nga çdo prodhues/operator, i cili është përgjegjës për një instalim për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, i cili përfshihet në veprimtaritë “instalimet për trajtimet me regjie dhe prodhimin e lëkurës”, referuar përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit. Ky vendim nuk zbatohet për operatorët e instalimeve, të cilët përdorin lëkurën si lëndë të parë për prodhimin e këpucëve, çantave dhe veshje apo aksesoreve të tjerë prej lëkure.

4. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr.10431/2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë kuptimin dhe përshkruajnë proceset, si më poshtë vijon:

a) “çgëlqerizimi”, procesi që konsiston në uljen e pH alkalit dhe neutralizimin e tij, me qëllim rigjallërimin e lëkurës;

b) “Depilimi”, procesi i kombinuar i shpërbërjes së qimeve dhe hidrolizës alkaline;

- c) “Gëlqerosja”, procesi teknologjik i gëlqerosjes, që konsiston në trajtimin e lëkurës me tretësirë të ngopur të kalciumit (Ca) nga 5 -15%, që kryhet pas procesit të heqjes së qimeve;
- ç) “Ngjyrimi”, procesi i ngjyrosjes të lëkurës me ngjyra, të cilat i jepen lëkurës sipas shijeve dhe kërkesave të tregut;
- d) “Pasregjia”, procesi i trajtimit të lëkurës, pas procesit të regjjes, i cili synon të përmirësojë vlerat e lëkurës;
- dh) “Piklimi”, procesi që synon uljen e pH, nëpërmjet shtimit të acideve;
- e) “Prodhues”, personi juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton dhe shet produkte të lëkurës si lëndë e parë;
- ë) “Regjia bimore”, procesi i trajtimit të lëkurës me esenca bimore, për të siguruar te lëkura qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj kalbjes;
- f) “Regjia kromike”, procesi që nënkupton trajtimin për regjie të lëkurës, duke përdorur kripëra të kromit (Cr);
- g) “Regjia”, procesi i trajtimit që synon transformimin e lëkurës pas çgëlqerosjes dhe trajtimit të saj me acid për të pasur një produkt të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj lagështisë dhe kalbjes nga agjentët mikrobikë;
- gj) “Skarifikimi”, procesi i heqjes së mishrave nga ana e brendshme e lëkurës;
- h) “Tharja”, një proces i largimit të lagështisë së tepërt të lëkurës;
- i) “Zbutja”, procesi për t’i dhënë lëkurës një lagështi dhe elasticitet të nevojshëm dhe të manovrueshëm.

5. Proceset teknologjike të parashikuara sipas përkufizimeve të pikës 4, të këtij kreu, janë procese, të cilat prodhuesi duhet t’i përshkruajë në aplikimin për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe aplikimit për t’u pajisur me lejen përkatëse të mjedisit, si dhe të deklarojë shkarkimet e mundshme në ajër, ujë, tokë dhe sasinë e mbetjeve, që do të gjenerohen për secilin proces, si dhe masat që do të merren specifikisht për shkarkimet e ndryshme gjatë proceseve të ndryshme.

II. KRITERET E VENDNDODHJES SË INSTALIMEVE

1. Instalimet për grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme për vendndodhjen e tyre:

- a) Të jenë brenda zonave industriale të përcaktuara në planet e përgjithshme vendore;
- b) Kur nuk ka zona të miratuara për zhvillimin e aktiviteteve industriale, instalimet:
 - i) të pozicionohen jo më pak se 2 000 m larg nga të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura dhe zonat e rekreacionit;
 - ii) të pozicionohen jo më pak se 2 000 m larg nga zonat me rëndësi për biodiversitetin, të miratuara nga autoritetet përkatëse;
 - iii) të pozicionohen jo më pak se 2 000 m larg nga zonat urbane;
 - iv) të jenë të zhvendosura rreth 1 000 m larg shtretërve të lumenjve.

III. MBETJET QË GJENEROHEN NGA INSTALIMET E PËRPUNIMIT DHE TRAJTIMIT TË LËKURËS

1. Mbetjet që gjenerohen gjatë procesit teknologjik të trajtimit të lëkurës janë, si më poshtë vijon:

- a) Mbetje të qimeve ose leshit, të gjeneruara gjatë proceseve të pastrimit të lëkurës, para trajtimit të tyre;
- b) Mbetje nga pjesët e trupit të kafshëve, si thundrat, brirët, pjesë nga qafa, koka, bishti etj.;
- c) Mbetje nga pastrimi dhe heqja e dhjamërave të lëkurës;
- ç) Mbetje të kripërave të kalciumit (NaCl), që dalin gjatë trajtimit dhe regjjes së lëkurës;
- d) Mbetje nga përbërës të taninës, të cilat janë rezultat i trajtimit me këto kimikate për të rritur fortësinë dhe rezistencën e lëkurës;
- dh) Mbetje nga kripërat e kromit, që përdoren në trajtimet kimike të lëkurës, që kanë për qëllim mbrojtjen e produkteve të lëkurës nga dëmtuesit dhe brejtësit;
- e) Mbetje nga kripërat e fosfateve.

IV. MASAT E NEVOJSHME PËR INSTALIMET E GRUMBULLIMIT, PËRPUNIMIT DHE TRAJTIMIT TË LËKURËS

1. Prodhuesi që operon në instalimet e grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës duhet të zhvillojë aktivitetin e tij vetëm pasi të jetë pajisur me lejen përkatëse të mjedisit, për çdo instalim.

2. Prodhuesi që operon në instalimet e grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës duhet të operojë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e kimikateve të rrezikshme, për menaxhimin e ujërave të ndotura industriale, për menaxhimin e shkarkimeve në ajër, për menaxhimin e mbetjeve organike dhe të ngurta dhe për menaxhimin e zhurmës në mjedis.

3. Këto instalime, përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, duhet të marrin masa edhe për zbatimin e kërkesave që rrjedhin nga konventa mbi tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër (CITES). Produktet e lëkurës ose gëzofët nga speciet e listuara në anekset e kësaj konvente janë subjekt i kufizimeve apo i detyrimit për marrjen e lejeve/certifikatave për eksportin/importin/rieksportin e tyre në vendet që janë palë të konventës CITES.

V. MASAT E NEVOJSHME PËR PARANDALIMIN E RREZIQEVE

1. Rreziqet potenciale gjatë procesit teknologjik vijnë nga:

a) kimikatat e përdorura në procesin e regjjes, të cilat mund të kenë veti të rrezikshme, të tilla si: ndezshmëri, toksicitet, potencial korroziv dhe potencial oksidimi;

b) agjentët biologjikë, që mund të vijnë nga bakteret, kërpudhat, merimangat dhe parazitët, që mund të jenë të pranishëm në lëkurë ose mund të formohen gjatë procesit të përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës;

c) ndotja e ujërave dhe tokës nga kloridet, taninet, kromi, sulfatet dhe sulfatet trivalent, si dhe kimikatat e tjera organike;

ç) zjarret ose shpërthimet në instalimet e grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit apo të tharjes, të cilët mund të përdorin një sërë materialesh të ndezshme. Shpërthimet ose zjarret mund të shkaktojnë dëme jo vetëm në instalime por edhe në mjediset përreth, si dhe në kontaminimin e ujërave, tokës dhe ajrit;

d) ndotja e ajrit dhe çlirimi i substancave të rrezikshme, si VOCs/ tretës organikë dhe sulfur hidrogjeni në ajër, të cilët rrezikojnë mjedisin.

2. Masat që duhet të merren për të shmangur dhe parandaluar rreziqet e sipërpërmendura janë, si më poshtë vijon:

a) Masa për menaxhimin e kimikateve të rrezikshme, referuar ligjit për menaxhimin e kimikateve dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) Masa për menaxhimin e ujërave të ndotura industriale, referuar ligjit nr.9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”;

c) Masa për menaxhimin e shkarkimeve në ajër, referuar vendimit nr.908, datë 21.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”;

ç) Masa për menaxhimin e mbetjeve organike, sipas përcaktimeve të vendimit nr.608, datë 17.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre” dhe legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

VI. MASAT E NEVOJSHME PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE TË RREZIKSHME

1. Për të shmangur ndotjen e mjedisit dhe rrezikimin e shëndetit të njeriut, kimikatat, të cilat përdoren gjatë procesit teknologjik të prodhimit, trajtimit, regjjes dhe përpunimit të lëkurës dhe që janë të kategorizuara si të rrezikshme, sipas vendimit nr.489, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) e të

kritereve për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve”, duhet që:

a) të jenë të etiketuara me simbole të përcaktuara, sipas kërkesave të vendimit nr.488, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”;

b) kimikatet që shkaktojnë reaksione në prani të kimikateve të tjera të mos ruhen në të njëjtin vend. Udhëzimet për pajtueshmërinë e kimikateve të ndryshme mund të merren nga të dhënat në etiketat dhe certifikatat e këtyre produkteve;

c) të magazinohen në ambiente të siguruara, të mbyllura, të mbuluara dhe të shtruara me beton, për të shmangur depërtimin e ujërave të shirave në vendet e ruajtjes së tyre apo ndotjen e tokës dhe ujërave sipërfaqësore në rast aksidentesh. Instalimet duhet të kenë sisteme kullimi që të mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr.9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, ose në një impiant grumbullimi, që parandalon derdhjen e lëngjeve dhe rënien në kontakt me mjedisin.

ç) të instalohen pajisje për dhënie alarmi, në rastet e shkarkimeve të depozitave nga tejmbushja apo të prezencës së gazeve toksike në ambientet e instalimeve.

2. Prodhuesi që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës të mbajë një regjistër për sasinë e kimikateve të përdorura gjatë proceseve teknologjike në instalim.

VII. MASAT E NEVOJSHME PËR TRAJTIMIN MJEDISOR TË UJËRAVE TË NDOTURA

1. Instalimet e përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës, që shkarkojnë ujëra të ndotura me përmbajtje të kimikateve dhe baktereve, që vijnë si rezultat i përdorimit të solucioneve të ndryshme gjatë procesit teknologjik, duhet të kenë:

a) sisteme të trajtimit të ujërave të ndotura industriale, si pjesë e proceseve teknologjike të prodhimit, të përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës, para shkarkimeve në gropat septike apo vende të tjera të lejuara;

b) kontratë me instalime të pajisura me lejen e mjedisit përkatës për shkarkimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane për proceset teknologjike që nuk përdorin kimikate apo që nuk gjenerojnë ujëra të ndotura industriale;

c) sisteme për trajtimin e ujërave të ndotura industriale që përmbushin kërkesat dhe standardet e përcaktuara në ligjin përkatës për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, si dhe në vendimin nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.

2. Ujërat e ndotura industriale, pasi trajtohen dhe neutralizohen, mund të shkarkohen në gropa septike apo në trupat ujorë pritës, nëse i përmbushin normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta, sipas vendimit nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.

3. Shkarkimet e ujërave të ndotura industriale, që janë pjesë e proceseve teknologjike të trajtimit me kimikate dhe me përmbajtje mbi normat kufi të përcaktuara për kromin, fosfatet dhe nitratat, sipas normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta, duhet të grumbullohen dhe të trajtohen në vaskat dekantuese përpara shkarkimit të tyre.

4. Ujërat e ndotura industriale, pas trajtimit mjedisor në impiante të posaçme trajtimi të licencuara dhe të pajisura me lejen përkatëse mjedisore, shkarkohen në gropa septike.

5. Prodhuesi që operon në instalimet për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës duhet të mbajë një regjistër, të shoqëruar me evidencat përkatëse, për sasinë e ujërave të ndotura që janë grumbulluar, trajtuar dhe shkarkuar nga instalimi.

VIII. MASAT E NEVOJSHME PËR MENAXHIMIN E SHKARKIMEVE NË AJËR DHE ZHURMAVE

1. Gazet që shkarkohen në atmosferë gjatë procesit të prodhimit, të trajtimit dhe të përpunimit të lëkurës janë, si më poshtë vijon:

a) Sulfidi i hidrogjenit, i cili çlirohet gjatë procesit të depilimit dhe është shumë toksik dhe i ndezshëm;

b) Komponimet organike të paqëndrueshme (VOCs) mund të çlirohen nga të gjitha proceset që përdorin tretës organikë;

c) Pluhuri dhe aromat, të cilat janë shqetësuese për zonat përreth instalimit.

2. Për të shmangur ndotjen e ajrit, shkarkimet e gazeve në ajër nga instalimet duhet të jenë brenda vlerave kufi, të përcaktuara në vendimin nr. 435, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”, si dhe pikat e shkarkimit të gazeve duhet të pajisen me sisteme ventilimi dhe trajtimi të shkarkimeve të gazeve.

3. Sistemet e ventilimit dhe të filtrave për kapjen e gazeve duhet të përmbushin kërkesat dhe standardet e përcaktuara në legjislacion në fuqi për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Shkarkimet e pluhurave dhe aromave në ajër nga instalimet duhet të jenë brenda vlerave kufi, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për cilësinë e ajrit.

5. Transportimi, lëvizjet brenda instalimit, si dhe përpunimi e trajtimi i lëkurës nëpërmjet proceseve teknologjike në këto instalime, duhet të bëhen në mënyrë të kontrolluar dhe profesionale, duke minimizuar kështu zhurmat dhe dridhjet.

6. Makineritë dhe pajisjet e përdorura në instalim duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin shoqërues që tregon të dhënat për fuqinë e zhurmës që lëshon. Këto makineri dhe pajisje duhet të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen gjatë procesit të punës në kushte të përshtatshme dhe efçente për të mos kaluar indikatorët e përcaktuar të zhurmës, me qëllim minimizimin e zhurmave.

7. Për instalimet e prodhimit, të grumbullimit, të përpunimit dhe të trajtimit të lëkurës duhet të ketë një procedurë të dokumentuar, ku të përshkruhet si shmangen ose minimizohen zhurmat dhe vibrimet, të cilat duhet të jenë brenda indikatorëve të përcaktuar në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

8. Prodhuesi duhet të marrë masa që instalimi për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurëve të jetë i rrethuar nga një brez i gjelbër, me lartësi minimumi 2 (dy) metra, me qëllim reduktimin e aromave të pakëndshme dhe uljen e nivelit të zhurmave, si dhe me një distancë të mjaftueshme nga objekti për të shmangur rrezikun e zjarrit.

9. Prodhuesi, që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës, duhet të mbajë një regjistër për sasinë e gazeve, pluhurave të shkarkuara dhe nivelin e zhurmave të lëshuara nga instalimi, si dhe çdo ndërhyrje apo mirëmbajtje në sistemet e ventilimit dhe të ndërrimit të filtrave.

IX. MASAT E NEVOJSHME PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE ORGANIKE DHE TË NGURTA

1. Mbetjet e krijuara nga procesi teknologjik si: mbetje të lëkurës, dhjamëra, qime, mbetje të tjera shtazore, të cilësuar si mbetje organike dhe komponimet e kromit dhe të sulfurit, të cilësuar si të ngurta, trajtohen të diferencuara në instalime për trajtimin e këtyre mbetjeve, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

2. Instalimet duhet të pajisen me lejen përkatëse mjedisore për trajtimin e mbetjeve të ngurta, sipas specifikës së tyre, deri në fazën e tyre përfundimtare që pushojnë së qeni mbetje.

3. Prodhuesi, që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, mban një regjistër për sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe duhet të ketë një plan për mënyrën e trajtimit të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

X. PËRGJEGJËSIA FINANCIARE E PRODHUESIT

1. Çdo person fizik/juridik, i cili prodhon, përpunon, trajton lëkurën dhe e shet, (prodhuesi), mbi baza profesionale, mban përgjegjësi financiare për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Operatorët, që e përdorin lëkurën si lëndë të parë për prodhimin e këpucëve, çantave, veshjeve dhe/apo aksesoreve të tjerë prej lëkure, kanë përgjegjësi të lidhin marrëveshje/kontratë për trajtimin e mbetjeve, që krijohen nga procesi me prodhuesin ose me një operator tjetër të

licencuar, që kryen operacione trajtimi të mbetjeve të lëkurës, sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet.

3. Në rastin kur kontrata/marrëveshja e parashikuar në pikën 2, të këtij kreu, lidhet me një operator tjetër të licencuar, që kryen operacione trajtimi të mbetjeve të lëkurës, kjo kontratë i vihet në dispozicion prodhuesit dhe përbën kusht për marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet prodhuesit dhe operatorit që përdor lëkurën si lëndë të parë.

XI. NDALIME

1. Në zbatim të këtij vendimi ndalohet:

a) përzjerja e ujërave larëse me ujërat e ndotura industriale, veçanërisht e atyre me përmbajtje substancash të rrezikshme;

b) shkarkimi i ujërave të ndotura në gropa septike, pa iu nënshtruar trajtimit paraprak të tyre, brenda normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta, sipas vendimit nr.177, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”;

c) depozitimi i mbetjeve organike në landfillet e mbetjeve urbane;

ç) përdorimi i kimikateve të paregjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit për menaxhimin e kimikateve;

d) instalimi dhe vënia në punë e veprimtarive, makinerive dhe impianteve të prodhimit të lëkurës, në mjedise të brendshme dhe të jashtme, pa zbatuar masa parandaluese e mbrojtëse, zhurma e të cilave kapërcen nivelet kufi.

2. Në rast se konstatohet kryerja e aktiviteteve të ndaluara, të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, ndërmerren masat ligjore dhe administrative për ndërprerjen, pezullimin, mbylljen apo sekuestrimin e instalimit, sipas shkallës së shkeljes, referuar dispozitave ligjore, përkatësisht: nenit 69, të ligjit nr.10431/2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar; nenit 29, të ligjit nr.10448/2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar; nenit 23, të ligjit nr.9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; nenit 62, të ligjit nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar; nenit 40, të ligjit nr.27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”; nenit 32, të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

XII. Monitorimi, raportimi dhe INSPEKTIMI

1. Prodhuesi, që operon në instalimet për grumbullimin, përpunimin dhe trajtimin e lëkurës, duhet të ketë sistem të miratuar për monitorimin dhe raportimin e rezultateve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas kërkesave të përcaktuara në lejen e mjedisit.

2. Sistemi i monitorimit përfshin, të paktën, si më poshtë vijon:

a) Kimikatet e përdorura;

b) Monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura;

c) Monitorimin e shkarkimeve në ajër;

ç) Monitorimin e mbetjeve organike dhe të ngurta që krijohen dhe mënyra e menaxhimit të tyre;

d) Monitorimin e zhurmave të shkaktuara nga instalimi;

dh) Sasitë e lëkurës të grumbulluara, të përpunuara, të trajtuara, të prodhuara e të shitura, si dhe llojet e tyre.

3. Inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin inspekton të gjithë operatorët ekonomikë të instalimeve të grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës, (prodhuesit) që veprimtaria e tyre është në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e integruar të mbetjeve, lejet e mjedisit dhe për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

4. Prodhuesit, të cilët janë subjekt i këtij vendimi, i vënë në dispozicion inspektoratit shtetëror përgjegjës për mjedisin të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në instalim.

XIII. DISPOZITA KALIMTARE

1. Të gjithë operatorët ekonomikë e një instalimi ekzistues për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës, brenda 9 (nëntë) muajve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, të fillojnë të marrin të gjitha masat teknike, ligjore, rregullatore, që instalimi të jetë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

2. Të gjithë operatorët ekonomikë të një instalimi ekzistues për grumbullimin, përpunimin, trajtimin dhe prodhimin e lëkurës, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

3. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij kreu, dhe në çdo rast, kur nga strukturat e kontrollit, të monitorimit dhe të inspektimit konstatohet mospërbushja e kërkesave të këtij vendimi, ndërmerren masat ligjore dhe administrative për ndërprerjen, pezullimin, mbylljen apo sekuestrimin e instalimit, sipas shkallës së shkeljes.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton kushtet e lejes së mjedisit për instalimet e reja të grumbullimit, të përpunimit, të trajtimit dhe të prodhimit të lëkurës si dhe rishikon kushtet e lejeve ekzistuese të mjedisit për instalimet ekzistuese, mbështetur në kërkesat e përcaktuara në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama